

VENDIM
Nr. 510 , datë 1.8.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.769, DATË 20.12.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI III’ (SHTESA)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.769, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, vlera “... 491 309 103 (katërqind e nëntëdhjetë e një milionë e treqind e nëntë mijë e njëqind e tre) lekësh ...” zëvendësohet me “... 509 350 091 (pesëqind e nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e një) lekësh ...”;

b) Në pikën 4 bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

i. Vlera “... 491 309 103 (katërqind e nëntëdhjetë e një milionë e treqind e nëntë mijë e njëqind e tre) lekësh ...” zëvendësohet me “... 509 350 091 (pesëqind e nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e një) lekësh ...”;

ii. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) 18 040 988 (tetëmbëdhjetë milionë e dyzet mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë përballohen nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”.

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

3. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

4. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE SHITESË E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA
NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI III” (SHITESA)

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE								TË DHËNA PËR SHPRONËSIM									SHËNIME (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale (m ²)	Arë (m ²)	Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	ARË			TRUALL			NDËRTESE				VLERA TOTALE (lekë)
												Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (tek/m ²)	Vlera (lekë)		
1	Zenepe Dhurata Saimir Bujar Liliana Luljeta Andrea Arjan Irena Kledian Gentiana Muhamet Suzana Shpëtim Shadije Besnik Ibrahim Faik Edmir Skënder Aida Servete Arben Fatmira	Reshit Asllan Asllan Muharrem Muharem Murat Agim Agim Fatmir Fatmir Fiqiri Fiqiri Fiqiri Hamid Hamdi Hamdi Jusuf Jusuf Jusuf Sadi Mahmut Sadi Isuf	Tagani Luga Tagani Luga Kazazi Ndreçka Papa Tagani Saraçi Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Halilaj Qefalia Qefalia Çali	Tiranë	8170	10/94	Truall	580		580						162	32878				5326236	Konfirmuar nga ASHK- ja
2	Zenepe Dhurata Saimir Bujar Liliana Luljeta Andrea Arjan Irena Kledian Gentiana Muhamet Suzana Shpëtim Shadije Besnik Ibrahim Faik Edmir Skënder	Reshit Asllan Asllan Muharrem Muharem Murat Murat Agim Agim Fatmir Fatmir Fiqiri Fiqiri Fiqiri Hamid Hamdi Hamdi Jusuf Isuf Jusuf	Tagani Luga Tagani Luga Kazazi Ndreçka Papa Tagani Saraçi Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia Qefalia	Tiranë	8170	10/95	Truall	979		979						384	32878				12625152	Konfirmuar nga ASHK- ja

[illegible]